



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISË

Programi: **Master**

Drejtimi: **Histori**

Lënda: STUDIME GJINORE

<i>Pedagogu:</i>	Dr. Gentiana Kera
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (15 javë: 2 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/semestri:</i>	II/I

Përshkrimi: Qëllimi i këtij cikli leksionesh është që të njohë studentët me qasjet metodologjike në kuadrin e Studimeve Gjinore, një fushë e cila synon të analizojë domethënien e gjinisë në shoqëri. Cikli i leksioneve synon të njohë studentët me çështjet, debatet dhe pyetjet kryesore në kuadrin e studimeve gjinore. Studimet gjinore analizojnë aspekte të pushtetit gjinor në sferat sociale, si në legjislacion, kulturë, punë, politika sociale, mjekësi, arsim dhe familje. Pyetje kryesore që do të ngrihen gjatë ciklit të leksioneve janë: pse gjinia ka qenë një nga parimet kryesore për organizimin e shoqërisë, si shpjegohet ndarja gjinore në ndarjen e punës dhe rolet gjinore në shoqëri, si funksionojnë strukturat e pushtetit mbi baza gjinore, cilët janë faktorët që kanë ndikuar në lindjen e lëvizjeve të grave dhe arritjet e këtyre lëvizjeve.

Në përfundim të ciklit të leksioneve studentët duhet të jenë në gjendje të kuptojnë debatet kryesore në fushën e studimeve gjinore, të përkufizojnë konceptet kryesore të fushës, dhe të përdorin metoda të ndryshme për analizën e gjinisë në shoqëri.

Temat e leksioneve:

1. Hyrje në Studimet Gjinore, burimet dhe metodat.
2. Industrializimi dhe urbanizimi në shek.19-të, Dallimet gjinore në sferën ekonomike, kulturore e politike.
3. Fillesat e debatit mbi gjininë. Lëvizja e grave në SHBA në shekullin e 19-të. Deklarata e Seneca Falls 1848.
4. Fillimet e lëvizjes femineiste në Europë.
5. E drejta e votës për gratë. Të drejtat politike për gratë.
6. Lëvizjet femineiste në Europë dhe ShBA në gjysmën e parë të shek.20
7. Lëvizja për të drejtat e grave pas Luftës së Dytë Botërore.
8. Paraqitja e grave në reklama dhe mediat vizuale. Stereotipet gjinore.
9. Seksualiteti dhe gjinia. Martesa dhe familja.
10. Gjinia dhe puna. Dallimet gjinore në punësim dhe rrjedhojat e tyre.
11. Gjinia dhe arsimimi.

12. Etniciteti, nacionalizmi dhe rolet gjinore.
13. Dhuna ndaj grave.
14. Aktivizmi i grave në Europën Juglindore në shek.20, pozita e gruas në shtetet socialiste.
15. Lëvizjet e gruas në Shqipëri në shek.20.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II: në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursit ose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

- Bassow, Susan (2003) Rolet dhe stereotipat gjinore, Tiranë, Dituria
- Dervishi, Z (2001) Gratë në syrin e ciklonit të sfidave dhe perspektivave, Tiranë.
- Fico, Delina (1999) "Women's groups: Albanian Case," Chris Corrin (bot.) *Gender and Identity in Central and Eastern Europe*, London, Portland: Routledge, 30-40.
- Haan De, Francisca/ Krassimira Daskalova/ Anna Lutfi (bot.) (2006) *A Biographical Dictionary of Women's Movements and Feminisms. Central, Eastern and South Eastern Europe, 19th – 20th Centuries*, Budapest/ New York: CEU Press.
- Musaj, Fatmira/ Enriketa Pandelejmoni (2012) "Gender Relations in Albania (1967-2009)," Caroline Hornstein Tomić, Krassimira Daskalova, Karl Kaser, Filip Radunović (bot.) *Gendering Post-Socialist Transition. Studies of Changing Gender Perspectives*, ERSTE Foundation Series 1 Münster: Lit.
- Musaj, Fatmira (2002) *Gruaja në Shqipëri 1912-1939*, Tirana: Akademia e Shkencave.
- Qendra e gruas (2004) Gra të sukseshme në politikën europiane.
- Qendra e gruas (2003) Studim mbi kontributin e shkruar të lëvizjes së gruas në Shqipëri
- Qendra e Gruas 2000) Përmbledhje esesh për përkatësinë gjinore.

Literatura plotësuese:

- Bataille, Georges (2013) Erotizmi, Tiranë, IDK.
- De Beavoir, S (2004) Seksi i dytë, vëll. 1 & 2, Tiranë, Cabej.
- Marcuse, Herbert (2008) Erosi dhe qytetërimi, Tiranë, Uegen.
- Musaj, Fatmira/ Beryl Nicholson (2011) "Women activists in Albania following independence and World War I," Ingrid Sharp/ Matthew Stibbe (botues) *Aftermaths of War: Women's Movements and Female Activists, 1918-1923*, Leiden: Brill, 179-196

MIRATOI

Përgjegjësi i Departamentit

Prof.As.Dr. Eva Hyskaj